



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3268/5 prot

Datë 18.11.2025

V E N D I M
Nr. 1699/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.11.2025, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62195-09-22-2025, me objekt “Blerje zjarrefikese per nevoja te bashkise Shijak”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK me NIPT L72322004M dhe adresë: Rruga Ali Demi , Kompleksi Vind, Shkalla B, Kati 4, Apartamenti 11, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Shijak me adresë: Lagja “Erzen” Shijak
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.09.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62195-09-22-2025, me objekt “Blerje zjarrefikese per nevoja te bashkise Shijak”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

II.2. Në datën 09.10.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 11.11.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave për vlerat pa TVSH si më poshtë:

- “Arteo 2018” SHPK	pa ofertë ekonomike	s kualifikuar
- Andi Hamo P.F	8 500 000 lekë	skualifikuar
-“Luar Bros” SHPK	9,994, 000 lekë	skualifikuar

II.3.1. Referuar raportit të auditit në SPE operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK rezulton i skualifikuar për arsye se:

“Subjeti Luar Bros nuk ka sjelle vertetim nga gjykata qe eshte i pa denuar sipas kriterëve te kerkuara ne DST.

Nuk ka regjistruar pronaret perfitues ne regjistrin e pronareve perfitues sipas parashikimeve te legjislacionit ne fuqi sipas kriterëve te kerkuara ne DST.”

II.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton, se më datë 11.11.2025 është publikuar njoftimi i anulimit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 13.11.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/6074 dhe me nr. 3268 prot., datë 14.11.2025 e operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62195-09-22-2025, me objekt “Blerje zjarrefikese per nevoja te bashkise Shijak”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.3268/1 prot., datë 14.11.2025.

II.7. Përmes shkresës me nr. 1578 prot., datë 17.11.2025 protokolluar me tonën me nr. 3268/2 prot., datë 18.11.2025 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP aktin e trajtimit të ankesës ku përmes vendimit nr. 396 prot., datë 17.11.2025 KSHA ka vendosur pranimin e saj konkretisht duke argumentuar:

“[...] Nga sa më sipër vërejmë se : Ne kete procedure kane mare pjese tre operatorë ekonomikë , të cilet jane skualifikuar me arsyet si me poshte : Në fazën e parë të vlerësimit nga ana e KVO janë skualifikuar Operatorët Ekonomikë si më poshte

ANDI HAMO me nr nipt K 76926201W nuk plotesohet kriteri 2.3.2 i DST , Subjekti ka paraqitur license VII.3.B.1, ne kundërshtim me kriteret e kerkuara ne DST. Nuk plotesohet kriteri 2.3.6 i DST , subjekti ka paraqitur vetem foto te mjetit ne kundërshtim me kriteret e kerkuara ne DST.

ARTEO 2018 me nr nipt L82523203F , nuk plotesohen kriteret e kerkuara ne DST ,Operatori ekonomik nuk ka ngarkuar ne sistem asnje dokument.

Pas dorëzimit të dosjes fizike dhe dokumentave provues sipas, VKM nr 285 datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Është skualifikuar subjekti ankimues me arsyet si më poshtë :

LUAR BROS me nr nipt L72322004M , Subjekti nuk ka sjelle asnje vertetim nga gjykata qe eshte i padenuar sipas kriterëve te DST . Nuk ka regjistruar pronaret perfitues ne regjistrin e pronareve perfitues ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi dhe sipas kriterëve te DST. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka marrë nën shqyrtim dokumentat provues, dhe ka

konstatuar se në dosjen fizike të dorëzuar pranë Autoriteit Kontraktor bashkia Shijak nga Subjekti “LUAR BROS” më datë 16.10.2025.

Ka paraqitur dokumentat provues :

Vërtetim të gjëndjes gjyqësore e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për subjektin ku rezulton të jetë i padënuar .

Dëshmi penaliteti e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për z. Arëbër Zejnati ku rezulton i padënuar . Dëshmi penaliteti e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për znj. Myzejene Zejnati ku rezulton e padënuar .

Vërtetime këto që faktojnë gjëndjen gjyqësore të subjekteve .

KVO ka renditur si arsye mos dorëzimin e ekstraktit të thjeshtë të pronarëve përfitues, Në gjykimin e KSHA ky është një vërtetim që gjenerohet elektronikisht dhe lehtësisht nga faqja zyrtare e QKB në kohë reale dhe nuk përbën shkak për skualifikim .

Operatori ekonomik dhe pse nuk i është kërkuar nga KVO ka paraqitur pranë AK vërtetimet si vijon :

Vërtetim nga prokuroria e gjyaktës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë , për subjektin LUAR BROS , shtetasin Arbër Zjenatin dhe shtetasin Myzejen Zejnati për të cilët rezulton të mos ketë procedim penal dhe mban datën 30.10.2025 .

Vërtetim nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë për subjektin LUAR BROS , shtetasin Arbër Zjenatin dhe shtetasin Myzejen Zejnati për të cilët rezulton të mos ketë proces themeli të cilët mbajnë datën 29.10.2025 .

Ekstrakt i thjeshtë i regjistrimit të pronarit përfitues i cili mban datën 27.10.2025 .

Pra për sa më sipër komisioni i shqyrtimit të ankesave për sa i lejon legjislacioni në fuqi është e mendimit se Ankesa juaj pranohet .”

II.9. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të *lex specialis* në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Përmes shkresës me nr. 1578 prot., datë 17.11.2025 protokolluar me tonën me nr. 3268/2 prot., datë 18.11.2025 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP aktin e trajtimit të ankesës ku përmes vendimit nr. 396 prot., datë 17.11.2025 KSHA ka vendosur pranimin e saj konkretisht duke argumentuar:

“[...] Nga sa më sipër vërejmë se : Ne kete procedure kane mare pjese tre operatorë ekonomikë , të cilet jane skualifikuar me arsyet si me poshte : Në fazën e parë të vlerësimit nga ana e KVO janë skualifikuar Operatorët Ekonomikë si më poshte

ANDI HAMO me nr nipt K 76926201W nuk plotesohet kriteri 2.3.2 i DST , Subjekti ka paraqitur license VII.3.B.1, ne kundërshtim me kriteret e kerkuara ne DST. Nuk plotesohet kriteri 2.3.6 i DST , subjekti ka paraqitur vetem foto te mjetit ne kundërshtim me kriteret e kerkuara ne DST.

ARTEO 2018 me nr nipt L82523203F , nuk plotesohen kriteret e kerkuara ne DST ,Operatori ekonomik nuk ka ngarkuar ne sistem asnje dokument.

Pas dorëzimit të dosjes fizike dhe dokumentave provues sipas, VKM nr 285 datë 19.05.2021
“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Është skualifikuar subjekti ankimues me arsyet si më poshtë :

LUAR BROS me nr nipt L72322004M , Subjekti nuk ka sjelle asnje vërtetim nga gjykata qe eshte i padënuar sipas kriterëve te DST . Nuk ka regjistruar pronaret përfitues ne regjistrin e pronareve përfitues ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi dhe sipas kriterëve te DST. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka marrë nën shqyrtim dokumentat provues, dhe ka konstatuar se në dosjen fizike të dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor bashkia Shijak ngaSubjekti “LUAR BROS” më datë 16.10.2025.

Ka paraqitur dokumentat provues :

Vërtetim të gjëndjes gjyqësore e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për subjektin ku rezulton të jetë i padënuar .

Dëshmi penaliteti e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për z. Arëbër Zejnati ku rezulton i padënuar . Dëshmi penaliteti e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për znj. Myzejene Zejnati ku rezulton e padënuar .

Vërtetime këto që faktojnë gjëndjen gjyqësore të subjekteve .

KVO ka renditur si arsye mos dorëzimin e ekstraktit të thjeshtë të pronarëve përfitues, Në gjykimin e KSHA ky është një vërtetim që gjenerohet elektronikisht dhe lehtësisht nga faqja zyrtare e QKB në kohë reale dhe nuk përbën shkak për skualifikim .

Operatori ekonomik dhe pse nuk i është kërkuar nga KVO ka paraqitur pranë AK vërtetimet si vijon :

Vërtetim nga prokuroria e gjyaktës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë , për subjektin LUAR BROS , shtetasin Arbër Zjenatin dhe shtetasin Myzejen Zejnati për të cilët rezulton të mos ketë procedim penal dhe mban datën 30.10.2025 .

Vërtetim nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë për subjektin LUAR BROS , shtetasin Arbër Zjenatin dhe shtetasin Myzejen Zejnati për të cilët rezulton të mos ketë proces themeli të cilët mbajnë datën 29.10.2025 .

Ekstrakt i thjeshtë i regjistrit të pronarit përfitues i cili mban datën 27.10.2025 .

Pra për sa më sipër komisioni i shqyrtimit të ankesave për sa i lejon legjislacioni në fuqi është e mendimit se Ankesa juaj pranohet .”

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe

vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në përputhje me parashikimet e nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe për këtë fakt bazuar në nenin 115 të ligjit të sipërcituar KPP do të mbyllë çështjen për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62195-09-22-2025, me objekt “Blerje zjarrefikese per nevoja te bashkise Shijak”, me fond limit 10,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 09.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

2. Autoriteti kontraktor të zbatojë vendimin e KSHA-së me nr. 396 datë 17.11.2025 të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike dhe protokolluar me tonën me nr. 3268/2 prot., datë 18.11.2025.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP mbi zbatimin e vendimit të KSHA duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

